



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
*Qeveria - Vlada - Government*

---


Nr. 01/110

Datë: 26.02.2010

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, si dhe të nenit 4 paragrafi (3) të Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës nr. 01/2007, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 26 shkurt 2010, mori

**V E N D I M**

1. Miratohet ekstrakti i procesverbalit dhe transkripti nga mbledhja e 109 e Qeverisë së Republikës së Kosovës.
2. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

  
Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përhershëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 02/110

Datë: 26.02.2010

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, si dhe të nenit 4 paragrafi (3) të Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës nr. 01/2007, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 26 shkurt 2010, mori

**V E N D I M**

1. Qeveria e Republikës së Kosovës, në bashkëpunim me EULEX-in, kërkon nga Prokuroria Speciale e Kosovës që në kuadër të saj të themeloj, një Departament Special Antikorrupsion, me qëllim të hulumtimit dhe luftimit të dukurive korruptuese në Kosovë.
2. Departamenti Special Antikorrupsion të përbëhet nga gjithsej 8 (tetë) prokurorë, 5 (pesë) prej të cilëve do të jenë vendorë ndërsa 3 (tre) prokurorëdo të emërohen nga autoritetet e EULEX-it.
3. Qeveria e Republikës së Kosovës për këtë qëllim merr përsipër përzgjedhjen dhe rekrutimin e 30 (tridhjetë) oficerëve hetues të Policisë së Kosovës, të cilët do të angazhohen drejtpërdrejt në hetimin e rasteve, të cilat do të hetohen nga Departamenti Special Antikorrupsion.
4. Përzgjedhja e 5 (pesë) ekspertëve, të cilët kanë përgatitje dhe eksperiencë adekuate në fushën e tatimeve dhe çështjeve tjera në luftimin e dukurive negative, do të bëhet përmes konkursit të hapur. Këta pesë ekspertë do të punojnë ekskluzivisht vetëm në çështje të cilat do të jenë kompetencë e Departamentit Special Antikorrupsion.
5. Qeveria e Republikës së Kosovës do të vejë në dispozicion të këtij Departamenti të gjitha resurset e nevojshme logjistike dhe stimulim financiar për punonjësit e këtij departamenti, në mënyrë që departamenti të jetë efikas në punën e tij.
6. Prokurorët dhe familjet e tyre do të kenë në dispozicion mbrojtjen e afërt fizike.

7. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen; Zyra e Kryeministrit, Ministria e Drejtësisë, Ministria e Punëve të Brendshme, Ministria e Ekonomisë dhe Financave dhe Ministria e Administratës Publike.
8. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përhershëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 03/110  
Datë: 26.02.2010

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, si dhe të nenit 4 paragrafi (3) të Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës nr. 01/2007, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 26 shkurt 2010, mori

**V E N D I M**

1. Ndahen mjetet financiare në shumën prej 50.000 (pesëdhjetëmijë) euro, ndihmë familjeve të cilët pësuan në aksidentin e ndodhur në Vjenë të Austrisë.
2. Mjetet financiare nga pika 1. e këtij vendimi ndahen nga rezervat e Qeverisë.
3. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen Ministria e Ekonomisë dhe Financave dhe Ministria e Punëve të Jashtme.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përhershëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
*Qeveria - Vlada - Government*


---

Nr. 04/110  
Datë: 26.02.2010

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, si dhe të nenit 4 paragrafi (3) të Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës nr. 01/2007, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 26 shkurt 2010, mori

**V E N D I M**

1. Miratohet Raporti Vjetor i Punës së Qeverisë së Kosovës për vitin 2009.
2. Ngarkohet Sekretari i Përhershëm i Zyrës së Kryeministrit që Raportin e përcaktuar në pikën 1. të këtij vendimi t'ia procedojë për njoftim Kuvendit të Republikës së Kosovës.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

  
Hashim THAÇI  
Kryeminister i Kosovës

Iu dërgohet:

- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përhershëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 05/110  
Datë: 26.02.2010

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, Nenit 33 paragrafi 1, të Ligjit mbi Hekurudhat e Republikës së Kosovës Nr. 03/L-076, si dhe të nenit 4 paragrafi (3) të Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës nr. 01/2007, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 26 shkurt 2010, mori

**V E N D I M**

**Mbi ndarjen e Hekurudhave të Kosovës Sh.A.**

**Neni 1**

- 1.1 Kompania - **Hekurudhat e Kosovës Sh.A.** - do të ndahet në dy kompani të pavarura Sh.A. me fushat e biznesit në:
- a) Menaxhimin, mirëmbajtjen dhe ndërtimin e infrastrukturës hekurudhore
  - b) Menaxhimin, operimin dhe ofrimin e shërbimeve të transportit të udhëtarëve dhe atij të mallrave me hekurudhë dhe me mjete tjera të transportit.
- 1.2 Të dyja kompanitë duhet të themelohen me këtë vendim të Qeverisë së Republikës së Kosovës si shoqëri aksionare. Ato do të jenë në pronësi të Republikës së Kosovës, e cila duhet të jetë pronare dhe aksionare, në pajtim me Ligjin mbi Ndërmarrjet Publike (Ligji Nr. 03/L-087), i cili është në fuqi (në vazhdim LmNP).
- 1.3 Të dy kompanitë si shoqëri aksionare janë:
- a.) **Infrastruktura e Hekurudhave të Kosovës ShA**, më tutje **INFRAKOS**, e cila është e ngarkuar me menaxhimin, mirëmbajtjen, përmirësimin, renovimin dhe ndërtimin e infrastrukturës hekurudhore; dhe

- b.) **Operimet me Trena të Hekurudhave të Kosovës ShA**, më tutje **TRAINKOS**, e cila është e ngarkuar me menaxhimin, mirëmbajtjen e mjeteve lëvizëse dhe ofrimin e shërbimeve të transportit të udhëtarëve dhe atij të mallrave me hekurudhë dhe me mjete tjera të transportit (Transporti Multi Modal).

## Neni 2

- 2.1 Në bazë të propozimit të Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave, Qeveria e Republikës së Kosovës në afatin jo më larg se 120 ditë, nga dita e miratimit, duhet të bëjë implementimin e këtij vendimi. Gjatë kësaj kohe, Ministri i Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave, në bashkëpunim me menaxhmentin e Hekurudhave të Kosovës ShA, duhet të përcaktojë se cilat asete (të luajtshme dhe të paluajtshme), aksione, të drejtat dhe vlerat likuide monetare të Hekurudhave të Kosovës ShA, do të bëhen asete të INFRAKOS dhe TRAINKOS në ditën e regjistrimit në Agjencionin për Regjistrimin e Bizneseve, dhe cilat asete duhet të mbeten si pronë e Republikës së Kosovës si të mira publike.
- 2.2 Asetet e infrastrukturës hekurudhore të cilat janë në pronësi të Republikës së Kosovës si të mira publike, duhet të menaxhohen në baza kontraktuale nga INFRAKOS. Ministri i Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave në emër të Republikës së Kosovës duhet të nënshkruajë kontratën me INFRAKOS, me të cilën përcaktohen të drejtat dhe obligimet e ndërsjella të përcaktuara në kapitullin IV të LmH.
- 2.3 Asetet e mbetura të Hekurudhave të Kosovës ShA, duhet të kalojnë në pronësi të TRAINKOS përmes një akti special mbi transferin apo pronësinë, të nënshkruar ndërmjet Ministrit të Ekonomisë dhe Financave, në emër të Republikës së Kosovës, dhe TRAINKOS.
- 2.4 Në ditën e futjes në regjistrin e Agjencionit për Regjistrimin e Bizneseve të kompanive, INFRAKOS duhet të marrë në zotërim asetet e infrastrukturës hekurudhore për menaxhimin dhe përdorimin e tyre.
- 2.5 Në ditën e futjes në regjistrin e Agjencionit për Regjistrimin e Bizneseve të kompanive, TRAINKOS duhet të bëhet pronare e aseteve të cilat i atribuohen asaj.
- 2.6 Përjashtim nga dispozitat e paragrafit 2.2 dhe 2.3 do të bëjnë ndërtesat e biznesit, në veçanti stacionet e udhëtarëve dhe терминаlet e mallrave, asetet e të cilave në mënyrë predominante përdoren për të mirën publike. Këto duhet t'i takojnë INFRAKOS-it me qëllim të futjes së konkurrencës ndërmjet operatorëve me trena dhe lejimit të zhvillimeve në të ardhmen të transportit multi modal të

udhëtarëve dhe mallrave dhe sigurimit të qasjes jo diskriminuese dhe fer për palët e treta.

- 2.7 Pas rekomandimit nga Hekurudhat e Kosovës ShA, bordet e kompanive, në ditën e shlyerjes së Hekurudhave të Kosovës ShA nga regjistri i Agjencionit për Regjistrimin e Bizneseve të kompanive, do të përcaktojnë se cilët punonjës do të punësohen nga INFRAKOS e cilët nga TRAINKOS.

### Neni 3

Në bazë të vendimeve që kërkohen në nenin 2, Ministri i Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave duhet të përcaktojë vlerën e ndarjes së kapitalit të të dy kompanive shoqëri aksionare.

### Neni 4

Të dy kompanitë shoqëri aksionare duhet të qeverisen si Ndërmarrje Publike Qendrore sipas dispozitave të LmNP.

### Neni 5

- 5.1 Bazuar në vendimet të cilat dalin nga Neni 3 dhe 4, Ministri i Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave, së bashku me Ministrin e Ministrisë së Transportit dhe Postë Telekomunikacionit, duhet të përcaktojnë të drejtat dhe obligimet të cilat Republika e Kosovës, si bartëse e aksioneve, do t'i ketë ndaj dy kompanive shoqëri aksionare, e në veçanti:
- a.) për krijimin e kornizës së politikave për të dy kompanitë shoqëri aksionare si aksionarë të rinj në sektorin hekurudhor nën ristrukturim, sipas LmNP.
  - b.) për aksionet dhe financimin e detyrimeve të INFRAKOS në drejtim të mbulimit të humbjeve, të cilat mund të ndodhin në të ardhmen, nga financimi i menaxhmentit, mirëmbajtjes, renovimit, përmirësimeve dhe ndërtimit të ri të infrastrukturës,
  - c.) për aksionet dhe financimin e detyrimeve të TRAINKOS në drejtim të përgatitjes të TRAINKOS për rolin e saj të ri, si ofruese e shërbimeve të transportit multi modal.
  - d.) për zgjedhjen e Bordit të Drejtorëve për dy kompanitë shoqëri aksionare
  - e.) për zgjedhjen e Komitetit të Auditimit.
- 5.2 Bazuar në vendimet të cilat dalin nga Neni 3, Qeveria duhet të emërojë personat të cilët në emër dhe në llogari të Republikës së Kosovës do të miratojnë dhe



nënshkruajnë dokumentet mbi themelimin e dy kompanive shoqëri aksionare dhe të ndërmarrin veprimet tjera të nevojshme për zbatimin e vendimeve.

#### Neni 6

- 6.1 Me propozimin e Ministrit të Ministrisë së Transportit dhe Postë Telekomunikacionit dhe Ministrit të Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave, Qeveria e Republikës së Kosovës mund të vendosë që në kohën e përshtatshme, pas themelimit të INFRAKOS-it, të nisë me transferimin e pjesshëm apo të plotë të menaxhimit, mirëmbajtjes, renovimit, përmirësimit dhe ndërtimit të infrastrukturës hekurudhore të INFRAKOS-it. Kjo mund të bëhet përmes partneritetit publiko privat (PPP) për ndonjë person legal vendor apo person legal të jashtëm të regjistruar në Republikën e Kosovës në mënyrë që të kujdesen për modernizimin e infrastrukturës hekurudhore.
- 6.2 Me propozimin e Ministrit të Ministrisë së Transportit dhe Postë Telekomunikacionit dhe Ministrit të Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave, Qeveria e Republikës së Kosovës mund të vendosë që në kohën e përshtatshme, pas themelimit të TRAINKOS, të nisë me transferimin e pjesshëm apo të plotë të aseteve të TRAINKOS për ndonjë person legal vendor apo person legal të jashtëm të regjistruar në Republikën e Kosovës në mënyrë që të promovojnë hapjen e tregut të sektorit hekurudhor të Kosovës dhe të fusin konkurrencën ndërmjet operatorëve të trenave.

#### Neni 7

- 7.1 Në ditën e regjistrimit në regjistrin e Agjencionit për Regjistrimin e Bizneseve të kompanive, për të dy kompanitë shoqëri aksionare, duhet të bëhet shlyerja e Hekurudhave të Kosovës Sh.A nga regjistri i Agjencionit për Regjistrimin e Bizneseve të kompanive.
- 7.2 Të dy kompanitë shoqëri aksionare duhet të jenë pasardhëse ligjore të Hekurudhave të Kosovës Sh.A sa i përket transferimit të aseteve dhe ndonjë të drejte apo obligimi tjetër, me përjashtim të obligimeve kreditore.
- 7.3 Obligimet ekzistuese kreditore të Hekurudhave të Kosovës Sh.A, duhet të pranohen nga Republika e Kosovës.

#### Neni 8

- 8.1 Deri në ditën e shlyerjes nga regjistri i Agjencionit për Regjistrimin e Bizneseve të kompanive, Hekurudhat e Kosovës Sh.A duhet t'i kryejnë të gjitha detyrat e tyre për menaxhimin e infrastrukturës hekurudhore dhe shërbimeve të transportit pa obligim për pajisje me licencat përkatëse, certifikatat e sigurisë, lejet e sigurisë dhe lejet tjera të përcaktuara me LmH.

- 8.2 Të dy kompanitë shoqëri aksionare, duhet që më së largu 180 ditë pas hyrjes në regjistrin e Agjencionit për Regjistrimin e Bizneseve të kompanive të aplikojnë për licenca, certifikata të sigurisë dhe certifikata tjera të përcaktuara me LmH. Deri në atë kohë ato duhet t'i kryejnë detyrat e tyre sikurse ato të janë të pajisura me lejet e tilla.

#### Neni 9

Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, hyjnë në funksion edhe dispozitat e nenit 33.1 të LmH.

#### Neni 10

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

~~Kryeministër i Kosovës~~

Iu dërgohet:

- të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përhershëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
*Qeveria - Vlada - Government*


---

Nr. 06/110  
Datë:26.02.2010

Në mbështetje të nenit 92 pika 4, dhe nenit 93 pika 4, të Kushtetutës të Republikës së Kosovës, si dhe të nenit 4, pika 3 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës nr. 01/2007, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 26 shkurt 2010, mori

**V E N D I M**

1. Për përmbylljen e procesit për rindërtimin e monumenteve dhe objekteve ortodokse, dëme të shkaktuara në trazirat e marsit 2004, zotohen mjete financiare në vlerë prej 533.331.59 (pesëqind e tridhjetetremijetreqindetridhjetenjë e pesëdhjetenëntë) euro.
2. Mjetet financiare nga pika 1. e këtij vendimi zotohen nga rezervat e Qeverisë.
3. Obligohet Ministria e Ekonomisë dhe Financave dhe Komisioni Implementues i Rindërtimit në Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit për zbatimin e këtij vendimi.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

  
Hashim THACI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përhershëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë